




Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Proceverbali i mledhjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)

Data: 19.06.2020

Vendi: Salla e Këshillit të Drejtorëve, në ndërtesën e komunës, Skenderaj

Ora: 11:00

RENDI I DITËS

- I. Njoftim mbi gjendjen me COVID-19 në Komunën e Skenderajt, z. Bekim Jashari;
- II. Diskutim rreth çështjes së sigurisë;
- III. Diskutim rreth dhunës në familje;
- IV. Siguria në shkolla dhe në afërsi të tyre;
- V. Të ndryshme

Të pranishëm në mbledhje:

1. Bekim Jashari, Kryesues i KKSB-së
2. Bekim Latifi- Drejtor i Arsimit në Komunën e Skenderaj
3. Hyka Ymeri- Zyrtare për Barazi Gjinore
4. Sokol Hoxha- Përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale
5. Mihane Bekteshi- Përfaqësuese e bizneseve
6. Kajtaz Gecaj- Media
7. Edisona Deliu- KLSP – Skenderaj
8. Nedelko Kovačević- Zyra për Komunitete

9. Qazim Miftari- KLSP
10. Enver Mulaj – Këshilli i Prindërve
11. Basri Durmishi- Komandant i Stacionit Policor në Skenderaj
12. Brahim Hetemi- “Hendikos”
13. Ibrahim Hoti- Përfaqësues nga Bashkësia Islame Skenderaj
14. KFOR

Fjala hyrëse

Mbledhjen e tretë për këtë vit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), e hapi Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, i cili njëherësh është edhe kryesues i KKSBB-së. Kryetari Jashari, njoftoi të pranishmit për pikat e rendit të ditës, me ç’ rast propozoi që të largohet nga rendi i ditës pika për diskutimin rreth dhunës në shkollë, për arsye se për shkak të pandemisë edhe mësimi në shkollë është pezulluar, ku me pëlqimin e gjithë të pranishmeve u largua nga rendi i ditës. Në këtë mbledhje gjithashtu u miratua edhe procesverbali i mbledhjes së datës 13.03.2020.

Kryetari i komunës, po ashtu raportoi para të pranishmëve për situatën aktuale të komunës përballë pandemisë COVID-19.

Kryetari Jashari: Lidhur me situatën e komunës, përballë virusit COVID-19, me lejoni të ju njoftoj se nga java e kaluar, ka filluar nëse mund të themi vala e dytë e virusit ku tani në komunën tonë kemi ku Brenda kësaj periudhë kemi shtatë raste pozitive me COVID-19, raste aktive për momentin i kemi dy në Likoc, një në Lubovec, dy në Polac, një në Mikushnicë dhe një në Ternavc. Për të pasur një kontroll me të mirë të familjeve në vetë izolim, kërkohet nga komandanti që e kemi këtu, do të thotë nga policia që kohë pas kohë të dal në kontrollo tek këto zona dhe këto familje për të parë nëse janë duke i respektuar këto masa. Për të gjitha këto raste QKMF- Skenderaj është duke ofruar shërbime të rregullta për pacient kurse ekipi mjekësor në Jarinjë po vazhdon ende të jetë aty, për të bërë kontrollimin e personave që hyjnë në shtetin e Kosovës. Sa i përket gjendjes ekonomike dhe sociale siç edhe e dini kemi shpërndarë pako higjienike e ushqimore për mbi 4 mijë familje, për dy herë radhazi brenda dy muajve, nga buxheti i komunës dhe nga përkrahja e donatorëve dhe e njerëzve të vullnetit të mirë. Së fundmi kemi marrë një vendim nga qeveria që të kontrollojmë hyrjet dhe daljet e institucioneve dhe kështu palët të mos lejohen të hyjnë në objektet komunale apo institucionet e tjera pa maska. Po ashtu sipas kërkesës së qeverisë do të reduktojmë edhe stafin e komunës, pasi që kështu na ka ardhur udhëzimi. Kjo ishte një informatë edhe shkurtër sa për këtë gjendje pandemike në komunën tonë, kush do që ka diçka ndonjë pyetje apo sqarim shtesë rreth kësaj, urdhëroni.

Kryetari Jashari tutje vazhdoi edhe me pikën tjetër të rendit të ditës atë të çështjes së sigurisë për të cilën edhe ja kaloi fjalën komandantit të Stacionit Policor në Skenderaj.

Komandanti **Basri Durmishi** njoftoi se rreth për çështjen e personave të cilët janë në vetë izolim policia gëzon bashkëpunim të mirë me QKMF dhe kjo situatë po menaxhohet si duhet. Po ashtu Durmishi falënderoj gjithë qytetarët të cilët edhe janë duke i respektuar vendimet dhe masat e vendosura nga qeveria por edhe komuna, gjithashtu Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, policinë e të gjithë të tjerët për kontributin e dhënë për menaxhimin e kësaj situate. Bashkëpunimi ka pasur edhe mes Policisë dhe Inspektoratit Komunal rreth objekteve dhe lokaleve të cilat janë hapur pa leje ose jashtë orarit të paraparë. Komandanti bëri të ditur se Policia edhe ka bërë ndërprerjen e disa aktiviteteve për shkak të situatës së pandemisë. Ndërsa sa i për ketë siguri në trafik Komandanti bëri të ditur se tani në një masë janë rritur edhe gjërat për parkimet ilegale dhe parregullsitë e tjera.

Me pas diskutimi kaloi tek pika tjetër e rendit të ditës asaj të **dhunës në familje**, ku fjalën Kryetari Jashari ia kaloi zyrtares për barazi gjinore në Komunën e Skenderajt, **Hyka Ymeri**.

Hyka Ymeri bëri të ditur se gjatë periudhës së pandemisë në Komunën e Skenderajt, numri i raportimit të dhunës në familje këtë vit krahasuar me vitin e kaluar është pak më i madh por jo vetëm në komunën tonë por edhe në komunat e tjera në përgjithësi.

Kurse tek pika e fundit të rendit të ditës, të ndryshme, fjalën e mori Brahim Hetemi, përfaqësues nga organizata Handikos, i cili falënderoj komunën për bashkëpunimin por edhe daljen në ndihmë për personat me aftësi të kufizuara sidomos gjatë kësaj periudhe kohore kur vendi po ballafaqohet me pandeminë e koronavirusit.

Në fund Kryetari Jashari bëri mbylljen e mbledhjes së radhës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, duke u pajtuar të gjithë të pranishmit që gjendja në komunë e menaxhueshme, stabile dhe e sigurtë.

Procesverbal mbajtësi:



Endrit Nura

Kryetari i Komunës:

Bekim Jashari

